

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR METROLOGJINË”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka për qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator për veprimtaritë në metrologjinë shkencore, industriale dhe ligjore, sipas praktikave më të mira evropiane, si dhe krijimin e një klime të lirë të ekonomisë së tregut.

Hartimi i këtij projektligji synon arritjen e disa objektivave si:

- a) përafrimin me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian;
- b) lëvizjen e lirë të instrumentave matës, në përputhje me MID (*Measuring Instruments Directive*);
- c) eliminimin e disa barrierave teknike të panevojshme në tregti;
- ç) unifikimin e termave të projektligjit, në përputhje me VIM (Fjalorin Ndërkombëtar të Metrologjisë);
- d) krijimin e dispozitave përkatëse që sigurojnë funksionimin e aktiviteteve metrologjike dhe të mbikëqyrjes së tregut, në dy institucione të ndara.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian, si dhe në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve për t’u miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektligji parashikohet të ketë një ndikim të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të praktikave për funksionimin e një tregu të sigurt, të lirë e konkurrues, në bashkëpunim me strukturën e mbikëqyrjes së tregut, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve, përmirësimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Shqipërisë duke ju garantuar nëpërmjet intrumenteve matës ligjërish të kontrolluar në treg, jo vetëm një ekonomi të konkurrencës së ndershme, por edhe mbrojtjen e intersave të tyre ekonomikë. Forcimi i mbikëqyrjes së tregut dhe

përmirësimi i zinxhirit dhe gjurmshëmërisë të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, duke garantuar konsumatorin me shërbime të sigurta dhe me standarte evropiane objekt i këtij ligji.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Gjithashtu, ky projektligj është në përputhje me ligjin nr.10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me legjislacionin në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Shkalla e përputhshmërisë së këtij projektligji me legjislacionin e BE-së, rezulton në një përputhshmëri të pjesshme, pasi projektligji është në përputhje me parimet kryesore të burimeve parësore dhe dytësore të *aquis-së*, por jo me të gjitha për shkak se implementimi i këtyre rregullave në praktikë nuk ka të njëjtin impakt pozitiv në vendin tonë, siç mund të ndodhë në shtete të tjera, duke iu referuar kushteve dhe rrethanave të ndryshme.

Projektligji i propozuar është në përputhje me:

1. Direktivën e Këshillit 80/181/EEC për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare, që kanë të bëjnë me njësitë e matjes;
2. Direktivën 2009/3/EC, datë 11 mars 2009, “Për njësitë e matjes”, e cila amendon direktivën 80/181 EEC;
3. Direktivën 2009/34/KE, datë 23 prill 2009, në lidhje me dispozitat e përbashkëta për instrumentet matëse dhe metodat e kontrollit metrologjik;
4. Direktivën 2007/45/EC, datë 5 shtator 2007, “Për vendosjen e rregullave për sasi të nominale të produkteve të parapaketuara”;
5. Direktivën 75/107/EEC, datë 20 janarit 1976, Për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me shishet që përdoren si enë matëse;
6. Direktivën 2014/31/EU, datë 26 shkurt 2014, “Për harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me vendosjen në dispozicion në treg të instrumenteve joautomatikë të peshimit” ;
7. Direktivën 2014/32 EC, për harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me përgatitjen dhe vendosjen në treg të instrumenteve matës;
8. Direktivën 76/211/EEC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 20 janar 1976.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 59 nene, të cilat janë të strukturuar në 9 krerë, të trajtuar si më poshtë vijon:

Kreu I ka në përmbajtje të tij dispozitat e përgjithshme të projektligjit që parashikojnë objektin, qëllimin e ligjit, fushën e veprimtarisë, përkufizimet e termave.

Objekti i këtij ligji është të rregullojë sistemin e njësisë së matjes, standardet e matjes, bazat për të siguruar gjurmueshmërinë e matjes, kontrollin metrologjik ligjor të instrumenteve matëse, dhe rregullat për organizimin dhe funksionimin e sistemit kombëtar metrologjik në Republikën e Shqipërisë.

Kreu II përcakton organizimin e sistemit kombëtar të metrologjisë, i cili përbëhet nga:

- a) Ministria përgjegjëse për ekonominë;
- b) Institucioni kombëtar shtetëror për metrologjinë/Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë;
- c) Laboratorët e autorizuar si mbajtës të etaloneve kombëtare dhe sekondare;
- ç) Personat juridikë privatë të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të kryer shërbimet e parashikuara në këtë ligj;
- d) Personat juridikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për të kryer verifikim periodik të instrumenteve në metrologjinë ligjore, sipas dispozitave të këtij ligji;
- dh) Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, për të kryer riparim të instrumenteve matës;
- e) Inspektorati shtetëror që mbulon fushën e metrologjisë.

Gjithashtu, në këtë kre janë specifikuar detyrat dhe kompetencat e strukturave që përbëjnë sistemin kombëtar të metrologjisë. Është parashikuar krijimi i Këshillit të Metrologjisë, si organ këshillimor që ngrihet dhe funksionon pranë Drejtorisë e Përgjithshme të Metrologjisë.

Kreu III “Njësitë e Matjes”, përcakton njësitë e matjes që përdoren në Republikën e Shqipërisë, konkretisht, njësitë e Sistemit Ndërkombëtar të Njësive të Matjes (SI), duke përfshirë shumëfishat dhe nënfishat e tyre, si dhe njësitë e matjeve jashtë Sistemit SI, që përdoren për transportin ajror, detar dhe hekurudhor, të miratuara me konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Kreu IV parashikon standartet matëse dhe është i ndarë në 2 pjesë: Pjesa I “Metrologjia shkencore” dhe pjesa II “Metrologjia industriale”

Në pjesën I “Metrologjia shkencore” përfshihen etalonet, laboratorët dhe detyrat e laboratorëve mbajtëse të etaloneve kombëtare të matjeve.

Pjesa II “Metrologjia industriale” përfshin gjurmueshmërinë e njësive të matjeve dhe kalibrimin e etalonëve të matjes dhe instrumenteve matëse. Kjo pjesë përmban dy nene “Gjurmueshmëria e njësive të matjeve” dhe “Kalibrimi i etaloneve të matjes dhe instrumenteve matëse”, që i referohen dokumenteve metrologjike (OIML D1), mendimit të ekspertëve të huaj, ligjeve të shteteve të tjera, si dhe eksperiencës shumëvjeçare të ligjit të metrologjisë.

Kreu V parashikon “Metrologjinë ligjore” dhe ndahet në katër pjesë.

Pjesa I përmban instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluar; vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre; detyrimet e përdoruesve të këtyre instrumenteve; miratimin e tipit; verifikimin e instrumenteve, llojin e verifikimit; shenjën e verifikimit; mbarimin e vlefshmërisë së verifikimit; përdorimin e instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar të riparuar; etalonët e matjeve dhe materialet referuese në metrologjinë ligjore.

Pjesa e II përmban “Ekspertizën metrologjike”, e cila konsiston në testim të jashtëzakonshëm dhe matje zyrtare të një instrumenti matës në bazë të një vendimi gjykate, kur rezultoni e nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi shërbimet, objekt i këtij ligji. Në rastet kur shërbimet, objekt i këtij ligji, kryhen nga persona juridikë privatë të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, çdo ekspertizë metrologjike do të kryhet nga trupa ndërkombëtare e akredituar.

Pjesa III “Parapaketimet dhe shishet” përmban dispozita që zbatohen në parapaketimet njëshe, të kombinuara, pa ambalazh mbështjellës dhe në enë matëse që janë prodhuar, hedhur në treg ose ofruar për shitje te një blerës i panjohur.

Shishet, si enë matëse, janë enë prej qelqi ose ndonjë materiali tjetër, që ruajnë formën e tyre të pandryshueshme, në përputhje me kërkesat metrologjike të përshkruara, kapaciteti nominal i të cilave është nga 0,05 - 5 litra, përfshirë dhe këto dy vlera.

Shishet, si enë matëse, duhet të pajisen me shenja që tregojnë vëllimin nominal dhe atë të mbushjes deri në buzë, si dhe me shenjën që identifikon prodhuesin e enës matëse.

Pjesa e IV “Dhënia e autorizimit”, përmban dhënien e autorizimit personave juridikë dhe fizikë, për të kryer veprimtari në metrologjinë ligjore. Gjithashtu, në këtë pjesë parashikohet afati, shfuqizimi, pavlefshmëria, publikimi i vendimit për autorizim, monitorimi dhe detyrimet e subjekteve të autorizuar.

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë vendos për dhënien e autorizimit brenda 60 ditëve nga aplikimi. Në vendimin përcaktohet qëllimin e autorizimit. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë 4-vjeçare.

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë cakton, gjithashtu, shenjën verifikuese të një personi të autorizuar prej saj për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Kreu VI parashikon “Inspektimin metrologjik”, konkretisht të drejtat dhe detyrimet e inspektorit, si dhe detyrimet e subjektit që inspektohet. Kështu, personat juridikë apo fizikë, veprimtaritë e të cilëve janë subjekt i inspektimit, janë të detyruar ta ndihmojnë inspektorin dhe t’i japin atij të dhënat dhe informacionet e domosdoshme që lidhen me objektin e inspektimit.

Ndërsa inspektori kontrollon:

- a) përdorimin e njësive ligjore të matjeve;
- b) konformitetin dhe përdorimin e instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar;
- c) konformitetin e parapaketimeve dhe shisheve, enë matëse, me masat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij;
- ç) mënyrën se si mbahen dhe përdoren regjistrimet dhe dokumentet e përshkruara.

Në rastet kur kryerja e shërbimeve, objekt i këtij ligji, realizohet ekskluzivisht nga persona juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, inspektimi metrologjik përfshin vetëm ekzaminimin fizik dhe dokumentar të produkteve apo proceseve, objekt i këtij ligji. Vetëm në raste përjashtimore dhe gjithmonë me vendim gjykate, inspektimi metrologjik mund të përfshijë dhe ekzaminim laboratorik, për të realizuar kontrollin.

Në rastet kur inspektori vëren shkelje të ligjit, apo çdo kontrate dhe/ose instrumenti që ka fuqinë zbatuese të ligjit, dhe që ka si objekt kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në këtë ligj, dhe të rregulloreve të miratuara, ose informohet për çdo shkelje nga subjekte të autorizuar për të kryer veprimtari metrologjike në një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, merr vendim aty për aty, por në çdo rast jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga konstatimi i shkeljes apo marrjes së informacionit nga subjektet e autorizuar prej ligjit. Sipas rastit, inspektori vendos një ose disa nga dënimet administrative që mund të jenë:

gjobë, pezullim apo bllokim të veprimtarisë, urdhëron korigjimin e parregullsive ose ndalimin e vendosjes në treg apo heqjen nga tregu të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluar, parapaketimeve dhe shisheve enë matëse.

Kreu VII parashikon masat financiare, mënyrën e financimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe pagesat dhe tarifat për shërbimet. Kalibrimi, miratimi i tipit, verifikimi fillestar dhe pasardhës, i instrumenteve matëse, miratimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve dhe të shisheve si enë matëse, shërbimet e metrologjisë ligjore të autorizuara me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, përfshirë edhe shërbime riparimi, si dhe trajnimet e ofruara kryhen kundrejt tarifave të miratuara nga autoritetet shtetërore përkatëse. Këto tarifa miratohen nga ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për ekonominë ose në një nga format e parashikuara në legjislacionin përkatës. Tarifat janë të njëjta si për subjektet vendase, ashtu dhe ato të huaja, që ushtrojnë veprimtari prodhimi ose shërbimi në Republikën e Shqipërisë dhe për rastet e shërbimeve, objekt i këtij ligji, ato parapagohen nga subjektet përkatëse.

Kreu VIII parashikon kundërvajtjet administrative, sanksionet, ankimet, ekzekutimi për kundërvajtjet administrative.

Në nenin 54 “Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet” parashikohen kundërvajtjet administrative dhe sanksione përkatëse. Masa e gjobës është përcaktuar në proporcion me llojin e shkeljes dhe me qëllim reduktimin e shkeljeve nga operatorët ekonomikë.

Gjoha ekzekutohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin për kundërvajtjet administrative. Të ardhurat e arkëtuara nga gjobat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Kreu IX parashikon dispozitat kalimtare, miratimin e akteve nënligjore, shfuqizimet dhe hyrjen në fuqi të projektligjit.

Është parashikuar nxjerrja e akteve nënligjore nga organet kompetente, çështjet që duhen rregulluar, sipas dispozitave përkatëse, në zbatim të këtij projektligji.

Neni 58 “Shfuqizimet”, parashikon shfuqizimin e ligjit nr.9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, të ndryshuar. Gjithashtu, si dispozitë kalimtare është përcaktuar që aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr.9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë” që nuk bien ndesh me dispozitat e këtij ligji, do vazhdojnë të jenë në fuqi deri në daljen e akteve të reja nënligjore përkatëse, referuar këtij ligji.

Në nenin 59 të projektligjit është parashikuar që ky projektligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, laboratorët e autorizuar si mbajtës të etalonëve kombëtare, personat juridikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për të kryer verifikim periodik të instrumentave në metrologjinë ligjore, personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga DPM-ja për të kryer riparim të instrumentave matës, inspektorati që mbulon fushën e metrologjisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e këtij projektligji ka kontribuar grupi i punës, i ngritur me urdhër ministri, me qëllim hartimin e projektligjit, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.

Ky projektligj nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë pasi nuk krijon ndonjë strukturë të re shtetërore, por do të shfrytëzohet e njëjta infrastrukturë ekzistuese (godina, pajisje, makineri etj).

KËSHILLI I MINISTRAVE